



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skup tina Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 24/15

Prishtinë, më 23.06.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Bali Muharremaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontić, Ilir Deda dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza Guvernator i BQK-së, Faton Ahmetaj Drejtor i BQK-së, Bedri Zymeri Drejtor i BQK-së, Arben Mustafa Drejtor i BQK-së, Agim Krasniqi Zv. Ministër, Adrian Zalli Drejtor Menaxhues i FKPK-së, Ymer Havolli Kryesues i Bordit të FKPK-së

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Paozina Nushi gazetare nga BIRN, Lumnje Murati - nga Zyra e Presidencës, Norë Shabani gazetare nga Koha Ditore, Pajazit Krasniqi gazetar nga RTK, Dona Luna gazetare nga Dukagjini

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 3.6.2015;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2014;**
4. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Faljen e Borxheve Publike;**
5. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014;**
6. **Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka njoftuar se është duke e bërë auditimin e pasqyrave financiare dhe raporti brenda dy javësh do të dërgohet në Kuvend. Me qëllim të shqyrtimit në të njëjtën kohë të raportit financiar dhe pasqyrave të audituara në Kuvend, propozoj që pika e 6 të shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër të Komisionit.

Sipas propozimit, Kryetari konstaton se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës me ndryshime, hiqet pika e gjashtë nga rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 3.6.2015

Kryetari konstaton se procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 3.6.2015, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2014

Kryetari njofton se në bazë të Ligjit për BQK-në, brenda gjashtë muajve pas mbylljes së vitit fiskal, BQK-ja duhet të dorëzojë Kuvendit raportin e aprovuar nga Bordi i Bankës Qendrore. Raporti duhet të përmbajë parashikimet mbi gjendjen e ekonomisë të vitit në vijim, arritjen e objektivave të politikave të saj, si dhe gjendjen e sistemit financiar të Kosovës. Raporti i BQK-së jep të dhëna për gjendjen ekonomike në përgjithësi, për ekonominë e Kosovës në sektorin real, sektorin fiskal, sektorin e jashtëm, dhe sektorin financiar duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e Institucioneve Financiare. Përveç kësaj, raporti përmban shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun. Po ashtu në raport përfshihen zhvillimet e brendshme dhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar.

Bedri Hamza njoftoi se raporti vjetor i BQK-së është përgatitur në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Bankën Qendrore dhe është miratuar nga Bordi i BQK-së më 21 maj 2015, dhe i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës dhe Ministrisë së Financave. Në vitin 2014 euro zona regjistroi rritje ekonomike prej 0.9% kundër rënies ekonomike prej 0.5% të shënuar në vitin paraprak. Faktor të rëndësishëm të rritjes ekonomike në eurozonë gjatë vitit 2015 pritet të jenë rënia e çmimit të naftës, zhvlerësimi i euros, rritja e eksporteve, dhe efektet e programit të lehtësimit sasior të ndërmarrë nga Banka Evropiane. Me normë pozitive të rritjes ekonomike u karakterizuan edhe vendet e rajonit të cilat regjistruan një normë mesatare të rritjes prej 1.6%. Ekonomia e Kosovës në përgjithësi ka arritur të ruaj stabilitetin makroekonomik duke shënuar normë pozitive të rritjes, stabilitet fiskal dhe financiar, si dhe normë të ultë të inflacionit përderisa raporti me sektorin e jashtëm vazhdon të karakterizohet me deficit të lart tregtar. Ekonomia e vendit për vitin 2014 shënoi normë reale të rritjes për 2.7% bazuar kryesisht në vlerësimin për rritjen e konsumit. Megjithatë, investimet dhe neto eksportet kishin ndikim negativ në rritjen ekonomike. Faktorët kryesor që ndikuan në rritjen e konsumit të përgjithshëm ishin rritja e pagave të sektorit publik, remitencat, dhe kredit konsumuese në sektorin bankar. Në anën tjetër, pozicioni i investimeve vlerësohet të ketë qenë më i pafavorshëm kryesisht si pasojë e rënies së investimeve publike në këtë periudhë, ndërkohë që edhe investimet e huaja direkte kanë shënuar rënie. Në kuadër të sektorit të jashtëm, përkundër normës më të lartë të rritjes së eksporteve në krahasim me importet, deficitin tregtar në mallra shënoi rritje duke arritur në 2.2 miliard.

Në vitin 2014 vlera e mallrave të eksportuara nga Kosova arriti në vlerë prej 324.6 milionë euro që përkon me një rritje vjetore prej 10.5%, ndërsa vlera e mallrave të importuara në vend arriti në 2.5 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.6%. Deficitin i lart tregtar vazhdon të jetë kontribuuesi kryesor i deficitit të llogaris rrjedhëse dhe kapitale që në vitin 2014 arriti 419.8 milion euro apo 7.7% e bruto produktit të brendshëm. Në vitin 2014, vlera e remitencave arriti në 693.7 milionë euro duke shënuar një rritje vjetore prej 11.7%. Në kuadër të llogarisë financiare kategoria kryesore vazhdon të përbëhet nga investimet e huaja direkte të cilat në vitin 2014 shënuan vlerën prej 123.9 milionë euro në krahasim me vlerën prej 250.2 milion në vitin paraprak. Republika e Kosovës vazhdon të ketë pozicion të kënaqshëm fiskal të karakterizuar me nivel të ulët të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Deficitin primar shënoi vlerën prej 131 milion euro krahasuar me vlerën prej 150 milionë euro që ishte e regjistruar në vitin 2013. Në të njëjtën kohë borxhi publik arriti në 582.9 milionë euro në krahasim me vlerën prej 476.3 që ishte në vitin 2013 apo 10.6% e bruto produktit të brendshëm. Financimi i deficitit buxhetor kryesisht u realizua përmes financimit të tregut të brendshëm të letrave me vlerë. Në këtë

kontekst përveç bonove të thesarit në vitin 2014 për herë të parë janë emetuar obligacionet qeveritare me afat maturimi prej dy vitesh. Rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare sidomos rënia e çmimit të naftës shkaktoj presion deflacioniste në nivel global posaçërisht në eurozonë. Këto zhvillime janë reflektuar edhe në Kosovë ku norma mesatare e inflacionit zbriti në 0.4% në vitin 2014 krahasuar me mesataren prej 1.8% që ishte në vitin paraprak.

Aktiviteti i sistemit financiar ka vazhduar të rritet dhe të ruaj shkallën e lart të qëndrueshmërisë. Në vitin 2014 vlera e gjithsej aseteve të sistemit financiar arriti në 4.5 miliardë euro, apo rreth 80% e bruto produktit të brendshëm, duke shënuar rritje vjetore prej 7.4%. Gjithsej kreditë arritën në vlerë prej 1.9 miliard euro që shënon një rritje vjetore prej 4.2%. Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomik vazhdon të dominohet nga kredi të destinuar për tregti 53.4%, prodhimtari 12% dhe ndërtimtari 8.4%. Norma mesatare e interesit në kredi për herë të parë që nga fillimi i funksionit të sektorit bankar në Kosovë zbriti në nivel një shifror gjegjësisht në 9.2% nga 11.1% të vitit 2013. Zvogëlimi i normës së interesit në kredi është paraprirë nga zvogëlimi i normës së interesit në depozita që zbriti në 1.1% nga 2.4% të vitit 2013. Zvogëlimi i normës së interesit në depozita kryesisht mund ti atribuohet likuiditetit të mjaftueshëm të sektorit bankar. Norma e rënies së interesit ka vazhduar gjatë muajve të parë të viti 2015 ku norma mesatare e interesit në kredi ishte 8.1% në maj, ndërsa në depozita 0.8%. Në vitin 2014 vlera e përgjithshëm e depozitave të sektorit bankar arriti në 2.5 miliardë euro që paraqet një normë vjetore të rritjes prej 3.6%. Treguesi i likuiditetit të bankave vazhdon të qëndroj mbi 40% që paraqet nivel mjaftë të lart se sa minimumi i kërkuar rregullator që është prej 25%. Po ashtu sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit prej 18% që paraqet nivel më të lart se sa minimumi rregullator prej 12% i kërkuar nga BQK. Kthimi mesatar i aseteve në sektorin bankar u ngrit në 1.9% nga 0.9% që ishte në vitin 2013. Në vitet paraprake aktiviteti kreditues nga institucionet mikrofinanciare është zvogëluar dukshëm, ndërsa në vitin 2014 ky sektor rriti mbështetje për ekonominë e vendit duke rritur kreditimin. Vlera e gjithsej kredive e këtyre institucioneve mikrofinanciare është 74.4 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 2.9%, përkundër rënies vjetore prej 6.7% sa është e shënuar në vitin 2013. Zhvillimet e favorshme u karakterizuan edhe në sektorin e sigurimeve me që rast vlera e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe arriti në 82 milion euro që është një rritje prej 3.7%, përderisa vlera totale e dëmeve të paguara arriti 33.4 milionë euro. Me rritje të aktivitetit dhe përmirësim të performances financiare karakterizohet sektori pensional.

Performanca e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës u karakterizua me një rritje të çmimit të aksionit dhe me kthim bruto nga investimet prej 66.7 milion euro. Sa i përket parashikimeve për vitin 2015 ekonomia e Kosovës do të përshpejtoj ritmin e rritjes duke arritur një normë reale të rritjes ekonomike prej 3.5%. Kjo rritje pritët të gjenerohet nga rritja e kërkesës së brendshme veçanërisht nga investimet publike dhe private. BQK për vitin 2014 në kuadër të funksionit të rregullatorit financiar ka punuar vazhdimisht në avancimin e legjislacionit sekondar dhe në harmonizimin me standardet ndërkombëtar. Në kuadër të aktivitetit licencues BQK ka dhënë një licencë preliminare për një degë të bankës së huaj, dhe janë aprovuar regjistrimet për katër institucione financiare jo bankare. Është lëshuar një licencë preliminare për një kompani të sigurimeve, ndërsa janë dhënë katër licenca të reja për ndërmjetësues të sigurimeve dhe janë aprovuar 32 agjent kontraktor. Raporti pasqyron edhe aktivitetin e mbikëqyrjes financiare ku është arritur avancimi i kapaciteteve në disa fusha përfshirë mbikëqyrjen bankare, sigurimeve, pensione, dhe institucioneve tjera financiare. Gjatë vitit 2014 BQK-ja ka ekzaminuar institucionet financiare për të siguruar zbatimin e rregullativës financiar dhe ligjeve në fuqi. BQK ka arritur të realizoj normë pozitive të kthimit në investime duke respektuar objektivat primare dhe ka pas progres edhe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Sipas opinionit të auditorit të jashtëm theksohet se pasqyrat financiare të BQK-së prezantojnë pozicionin financiar në mënyrë të drejt të gjitha aspektet materiale.

Kryetari është brengosje rënia e investimeve publike dhe rënia e investimeve të huaja direkte prej 22.3%. Mesatarja e Inflacionit në vitin 2014 ishte 0.4% nga 1.8% në vitin paraprak, dhe kjo ka krijuar

një stabilitet në konsum. Për shkak të ekonomisë së brishtë të Kosovës, bilanci tregtar është negativ. Kosova ka një import prej 2.5 miliardë euro me një rritje vjetore prej 3.6%, ndërsa ka eksport prej 324.6 milionë euro kryesisht bazuar në eksportin e metaleve. Remitencat për Kosovën paraqesin një burim kryesor. Fal remitencave që i kemi nga diaspora, me ndikimin e Parlamentit dhe Guvernatori të BQK-së arritën të paktën të bëjnë një lehtësim për tarifën kufitare me vendimin e fundit për zbritje prej 50%. Politikat e BQK-së lidhur me funksionimin e mirë dhe stabilitetin bankar janë shumë të rëndësishme edhe për shkak të mungesës së politikave monetare. Megjithatë, ekziston nevoja e rregullimit të ligjeve që i rregullojnë instrumentet e pagesave në Kosovë, qoftë për Kambialin apo pagesave tjera që kryen më letrat në vlerë. Raporti prezanton se ka stabilitet te bankat por ekziston një dilemë për arsye se ekonomia e Kosovës, si sektori biznesor nuk është në gjendje me absorbue potencialin financiar që këto banka kanë në dispozicion. Cilët janë faktorët për rënien e kamatave prej 9.2%, a është çështje e mungesës së potencialit ekonomi apo janë kushtet të cilat me një lloj monopoli i mbajnë kamatat me norma të larta? Fondi i Kursimeve Pensionale ka arrit në 1.1 miliard me politika që konsiderohen të jenë konservative. Megjithatë, Kosovë është një vend i cili paraja nuk qarkullon dhe paraja është më e prirur që nga institucionet financiare, të plasohet në tregjet bankare jashtë Kosovës, ndoshta për shkak të sigurisë. Në politikat investive duhet të gjindet një formë më e përshtatshme dhe më e lehtë për bizneset që të marrin kredi dhe ti shpenzojnë ato në potencialin ekonomik.

Safete Hadergjona në raport kemi vërejt se gjërat janë për tu vlerësuar në aspektin e përgjithshëm të ekonomisë në Kosovë. Në paraqitjen e ekonomisë së Kosovës, ka një rënie të investimeve publike prej 22.3%, që në fakt në vitet paraprak ka pasur një trend të rritjes, dhe tani kemi një trend të zbritjes së këtyre investimeve publike dhe të investimeve të huaja direkte prej 46%, të cilat kanë refleksione në zhvillimin ekonomik të vendit. Ka një lëvizje pozitive ose rritje në drejtim të eksporteve prej 10.5%, kurse rritja e importeve vjetore ka qenë 3.6%. Sa i përket kredive nuk kanë qenë shumë të favorshme edhe pse po shohim se tash ka filluar të bie norma e interesit. Janë dy çështje që kërkojnë me shumë sqarime sipas raportit vërehet se janë 13 institucione mikrofinanciare edhe 47 institucione financiare jobankare. A ka pas vështirësi në monitorimin dhe në mbikëqyrjen e këtyre institucioneve, për shkak të zbrazëtirës ligjore dhe si keni arritur të bëni mbikëqyrjen e tyre dhe a keni vërejt parregullsi në këtë fushë bazuar me legjislacionin faktik që është në fuqi? Nga raporti vërehet se janë 13 kompani të sigurimeve prej të cilave 10 kompani sigurimi jo jetë, ndërsa 3 jetë. Nga 12 ekzaminime që i keni bërë këtyre institucioneve, keni vërejt se ka disa mungesa në këtë fushë dhe i keni theksuar mungesat, çka çfarë masash juridike keni ndërmarrë ndaj këtyre institucioneve? Sa i përket të gjeturave nga ekzaminimi i kompanive të sigurimeve sa keni arritur ti vëni këto kompani në baza të shëndosha të funksionimit të tyre?

Besa Gaxherri në bazë të raportit vërehet që Kosova ka një stabilitet makroekonomik financiar. Mirëpo në realitet sidomos tek normat shumë të larta të kamatave del diçka tjetër. Është shqetësuese rënia e investimeve publike dhe e investimeve të huaja. Normat e kredive janë ende të larta edhe pse ka rënie në 9.2%. Jemi në dijeni që funksionon ekonomia e tregut të lirë dhe që ekonomia e këtij vendi është e varur prej kredive bankare, megjithatë çfarë keni ndërmarr ju si rregullator? Bazuar në sigurinë financiare të bankave janë krejtësisht të paarsyeshme këto kamata që i kemi sot.

Kryetari do të ishte mirë që përveç këtyre pyetjeve të sqarohet se çka përmban borxhi i brendshëm që ka rritje prej 61%. A ka mundësi të detalizohet borxhi i brendshëm që është në shumë prej 265 milionë?

Bedri Hamza kemi nevojë që më tutje të avancojmë legjislacionin që kanë impakt në fushën e sektorit financiar, siç është ligji për rregullimin e kamatës në vonesë, ligji për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe ligji për instrumentet e pagesës që është ligji i kambialit. Kredit familjare kanë shënuar më tepër rritje se sa kredit për biznese. Bankave i kemi shpjeguar që në staza afatgjate nuk mund të llogaritej në fitime nëse nuk ka rritje të sektorit privat. Kemi punuar bashkarisht

për eliminimin e faktorëve që kanë ndikuar në lartësinë e normës së interesit. Faktorët që kanë ndikuar në uljen e kamatave, në një është rritur konkurrenca e bankave me licencimin e bankave të reja mjaftë të fuqishme, dhe nën dy janë eliminuar faktorët e riskut dhe përmbaruesit privat e kanë bërë efektin e vet në ekzekutimin e lëndëve të bankave. Nëse i referohemi të dhënave të fundit për normën mesatare ku hyn të gjitha kredit ka rënë nën 8%, ndërsa kur flasim për kredit e reja, atëherë sillen në mesatare prej 4% deri 7% dhe në këtë aspekt, Kosova është në mesataren e vendeve të regjionit. Ecurit në eurozonë deri në vitin e kaluar kanë pas një normë negative të rritjes dhe kjo ka ndikuar në rënien e investimeve direkt të huaja. Ndërkaq, për tre muajt e parë të vitit aktual kemi rritje të investimeve të huaja direkte dhe nga 37.5 milionë që i kemi pas vitin e kaluar, tani kemi 77.9 milionë euro, që është një rritje rreth 100%. Sa i përket eksporteve për tremujorin e parë kanë arritur vlerën në 103.7 milionë euro që paraqet një rritje vjetore për 15% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. BQK e ka rregullativën sa i përket mbikëqyrjes së institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare dhe nuk ka probleme në këtë aspekt. Ato janë mbikëqyr janë evidencuar shkeljet ka pas pezullim të licencave për këtë kategori të subjekteve juridike dhe ka pas edhe masa ndëshkuese. Problemi është tek statusi juridik i këtyre institucioneve ne e kemi një situatë të trashëguar ku shumica operojnë si subjekte juridike me statusin e jopërfituesit publik si OJQ, ndërsa realizojnë profit. Sa i përket kompanive të sigurimit është një sektor ku është punuar shumë, dhe është fat i mirë që Qeveria e ka kaluar ligjin për sigurimet e përgjithshme dhe presim që Kuvendi ta aprovon. Disa prej këtyre kompanive kanë qenë të nën kapitalizuara dhe është dashtë të punohet që këto të kapitalizohen. Sot nuk ka kompani që është në treg dhe që nuk e kanë kapitalin e kërkuar me ligj.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor të punës i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2014.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Faljen e Borxheve Publike

Kryetari çështjet kryesore e trajtuar në këtë Projektligj është falja e borxheve publike ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike, si dhe përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për faljen e borxheve, që personat fizik dhe juridik kanë për periudhën deri më 31 dhjetor 2008. Përveç qëllimit të këtij projektligji, duhet të informohemi se sa falen borxhet dhe kujt i përkasin këto borxhe. Për më tepër sa përfitojnë qytetarët, sa subjektet juridike, dhe cili është interesi i këtij vendimi që është shumë i rëndësishëm nga kjo periudhë të qeverisjes së re?

Agim Krasniqi Projektligji përcaktohen kriteret dhe procedurat për faljen e borxhit publik për personat fizik dhe juridik. Sipas këtij ligji do të falet borxhi publik që nënkupton çdo shumë e papaguar e borxhit duke i përfshirë ndëshkimet, gjrobat, interesin, dhe çdo obligim tjetër që vjen nga mos pagesa me kohë e borxhit sipas gjendjes në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Projektligji i përket personave që kanë obligim ndaj institucioneve shtetërore me emër të obligimeve tatimore, doganore, tatimit në pronë dhe të gjitha obligimeve tjera financiare deri më 31 dhjetor 2008. Personat fizik dhe juridik duhet të kryen pagesën e plotë të obligimeve për periudhën 1 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014, në bazë të marrëveshjes që do të lidhin marrëveshje me institucionet shtetërore. Pagesa e borxhit sipas këtyre do të kryhet brenda një afati prej dy viteve për personat juridik nga data e lindjes së marrëveshjes dhe brenda afatit prej tre vite për personat fizik nga data e lindjes së marrëveshjes. Sipas vlerësimit të institucioneve shuma e borxhit që do të falet vlerësohet të jetë rreth 680 milionë euro , prej tyre rreth 148 milion janë borxh ndaj ATK-së, 6 milion janë borxh ndaj Doganës së Kosovës, 57 milion janë borxh i tatimit në pronë, dhe pjesa kryesore ka të bëjë me shumën rreth 465 milion që janë borxhe ndaj ndërmarrjeve

publike. Janë bërë analizat nga një institucion joqeveritar dhe del që 90% e përfituesve do të jenë kryesisht qytetarët që nuk kanë mundur ti paguajnë obligimet deri tani. Përfitues mund të jenë edhe firmat.

Kryetari A i është fal borxhi vetëm atyre ndërmarrjeve që kanë bankrotuar dhe më nuk janë aktive në ekonomi, apo edhe atyre që nuk i kanë kryer obligimet por janë ende aktive në ekonomi? A ka ndonjë kriter apo falen borxhet në përgjithësi deri në këtë datë të caktuar? Nëse sektorit të biznesit i falen 152 milionë, krahasuar me shumën totale të faljes së borxheve prej 680 milion euro, atëherë nuk del që 90% e qytetarëve nuk përfitojnë. Te neni 6, pika 2, ku thuhet se nuk amnistohen personat nga çfarë do përgjegjësie penale që ka lindur për shkak të mos përmbushjes të obligimit financiar. Nëse e keni propozuar faljen e borxhit me ligj dhe mbi këtë bazë të borxhit ndonjë person është penalisht i ndjekur, ku ekziston arsyeshmëria të ndjekjet dhe më tutje?

Agim Krasniqi te paragrafi 2 i nenit të 6 duhet të rishikohet gjuha juridike edhe njëherë bashkarisht. Ky ligj do të përcillet edhe me akte tjera nënligjore që do të sqarojnë ato që kanë mbetur pa u sqaruar. Ajo çka është me rëndësi të gjitha institucionet preken nga ky ligj, brenda një afati të caktuar duhet ti përgatisin listat për personat dhe juridik edhe fizik, që do t'iu falen borxhet brenda afateve të përcaktuara me këtë projektligj.

Safete Hadergjona - është shumë e paarsyeshme që të bëhet falja e borxheve për bizneset që janë funksionale dhe që janë të fuqishëm edhe sot. Të dënohet një biznes që ka kontribuar në ndërtimin e shtetit, në mbushjen e buxheti të shteti duke paguar obligimet që i ka pas prej fillimit e deri tash, e të favorizohen bizneset tjera që janë të fuqishme në tregun e Kosovës sot, që nuk kanë paguar asnjë obligim ndaj shtetit nuk po më duket që është e arsyeshme. Unë jam për faljen e borxheve për qytetarët sepse kanë qenë rrethanat ashtu, por nuk pajtohem për faljen e borxheve ndaj bizneseve që kanë pasur obligime dhe mundësi të paguajnë dhe nuk e kanë paguar borxhin e tyre.

Bali Muharremaj - përmes këtij ligji nuk po trajtohen të gjithë barabartë. Ky ligj po destimulon taksapaguesit dhe qytetarët e përgjegjshëm, ndërsa po i stimulon tatimpaguesit e papërgjegjshëm që nuk kanë kryer obligimet ndaj shtetit. Me këtë ligj por fillohet të amnistohen obligimet ligjore ndaj tatimpaguesve që përmes lidhjeve kanë arritur ti shmangen edhe pagesave dhe kryerjes së obligimeve ligjore. Në fund dua të them se kjo nuk e stimulon as konkurrencën reale dhe as zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Kryetari - mendoj se është një projektligj i domosdoshëm, që është jashtëzakonisht i qëlluar, dhe duhet ta përkrahim dhe pas miratimit në lexim të parë në Kuvend, si komision funksional do të analizojmë dhe bëjmë ndryshimet e nevojshme.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë në parim Projektligjin për Faljen e Borxheve Publike.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014

Kryetari - raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014 përmban të dhëna për aktivitetet, investimet e kursimeve pensionale, kontribuimi dhe pensionimet, si dhe të dhëna për shpenzimet e taksës investive.

Ymer Havolli si rezultat i performancës në tregjet ndërkombëtare, për tri vitet e fundit kemi një kthim. Në vitin 2014, mjetet nën menaxhim janë dikun 1,087,760 miliard euro, krahasuar me një vit më parë prej 913 milion euro. Sa i përket llogarive të kontributeve pensionale gjatë viti 2014 është rritur duke kapur shifrën vjetore prej 129 milion, apo kemi një rritje prej 8% krahasuar me vitin e kaluar. Fondi hapi 29,300 llogari të reja individuale duke e çuar numrin e përgjithshëm të llogarive të hapura qysh prej themelimit në 476,559. Kemi investuar mjetet edhe në tregun e Kosovës dhe në bazë të ligjit, kemi pasur mundësi të investojmë tek bankat dhe bonat e thesarit të qeverisë dhe deri më tani në Kosovë kemi investuar një shumë prej 142 milion euro. Tek shpenzimet operacionale, ka pasur rritje në të gjitha fushat, si në marrëdhëniet me klientët që duhet të bëjmë shpërndarjen e pasqyrave, çështja e adresave të kontributdhënësve dhe në bashkëpunim me ATK-në kemi arritur të reduktojmë masën e mjeteve të paalokuara të cilat kanë qenë 21 milion, ndërsa tani i kemi 10 milion.

Kryetari - në vitin raportues ka një rritje prej 27.5% e shpenzimeve operacionale, krahasuar me vitin paraprak, sepse në raport nuk kemi krahasime me planifikimin që konsiderojë se është një lëshim. Kemi tejkalim pothuajse në gjitha kategoritë e shpenzimeve. A jo çka është inkurajuese është që ka një shumë të madhe të investimeve diku 333 milion. Sa i përket investimeve, në Kosovë janë të plasura vetëm 50 milion euro, ndërsa mjetet tjera janë të investuara jashtë Kosove, kjo nënkupton se nuk është problem që paret nuk i kemi, por është se nuk kemi potencial ekonomik, dhe në këtë drejtim edhe politikat e fondit janë mjaftë konzervative për shkak të sigurisë së lartë në investimin e këtyre mjeteve. Ndërkaq në bazë të raportimit të BQK-së, sistemi bankar në Kosovë është mjaftë me likuiditet të mirë, dhe shtrohet pyetja pse nuk ka plasman më të madh të mjeteve të Fondit në bankat që operojnë në Kosovë, që kishte me ndikue edhe në konkurrencë më të madhe në këtë sektor dhe me u zbritur edhe më shumë norma të kamatave?

Bali Muharremaj përgëzojë për përgatitjen teknike të raportit, ndërkaq ajo që më intereson të dijë është se me çfarë kamata janë investuar mjetet jashtë vendit dhe a ka ndonjë metodë që këto para që janë të popullit të investohen brenda vendit, për zhvillimin ekonomik të shtetit?

Besa Gaxherri - raporti është gjithëpërfshirës dhe i përgatitur mirë teknikisht, por realisht i keni edhe mundësitë dhe kushtet për të përgatitur një raport të tillë. Duke pasur parasysh faktin se keni kushte të mira të punës, dhe ne ju kemi ofruar pagesën për me e pas ekspertizë brenda në Fond, çfarë bëni bërë gjatë këtyre viteve që konkretisht të na ofroni se çfarë duhet ndryshuar në legjislacion, që mjetet e fondit me u investu në Kosovë dhe konsiderojë se ju duhet të bëni analiza dhe ofroni rekomandime në këtë drejtim?

Bardhyl Meta ajo që është brengosëse që u diskutuar më herët me BQK-në, janë rënia e investimeve të huaja direkte që krahasuar me vitin 2007, investimet kanë rënë për shtatë herë më shumë. Përkundër tregut jostabil që vlerësohet, ne po kërkojmë që mjetet tona me i rrezikue këtu, e jo në tregun financiar botëror. Prandaj, kur po flasim te tregjet financiare duhet pas parasysh se mungesa e shtetit ligjor, e mosefikasiteti i gjykatave, të prokurorisë e policisë, të gjitha këta faktorë, ndikojnë tek investitorët që e shikojnë tregun me seriozitet, e jo si treg emocional, që në këtë rast do të rrezikonim humbjen e pensioneve. Ajo çka përgëzojë Fondin është se ka diversifikim të investimeve të mjeteve dhe financim në më shumë fonde dhe përgjatë viteve të fundit kemi kthim pozitiv të mjeteve.

Adrian Zalli- ne kemi hapura tender për investimin e mjeteve dhe nuk ka pasur interes asnjë interes prej bankave, bankat kanë aq shumë pare, sa që nuk dëshirojnë të marrin mjetet tona. Si rezultat, për mos me i kap inflacioni, këto të holla na duhet me i investue. Numri i llogarimbajtësve në Fond janë 476,559 që janë aktive dhe gjatë vitit 2014, 285,000 kontribues kanë derdhura para në llogaritë e përmendura. Është për tu brengosur se prej kësaj shifre prej 285 mijë, 85,000 janë shërbyes civil dhe në

bazë të kalkulimeve, duke pasur parasysh numrin e popullsisë, në del se po punojnë vetëm 16% zyrtarisht në Kosovë. E drejta e tërheqjes së pensioneve, në bazë të ligjit është kur dikush i mbush 65 vjet dhe në bazë të Rregullores që e ka aprovuar Banka Qendrore, deri në shumën 2,250 euro, ka të drejtë i pensionuar ti tërheq menjëherë. Por nëse a kontribuar më shumë, ai ka të drejtë të tërheqjes së shumës deri në 20% dhe pjesën prej 80% mundet me tërheq në shumë prej 150 euro për çdo muaj ose 1.5% nëse ka më shumë se 15 milion, e nëse i ka 50,000 euro i tërheq 500 euro në muaj.

Bali Muharremaj - pyeti si ka mundësi që drejtori menaxhues me pas pagën 6,000 apo 7,000 euro?

Ymer Havolli - pagat e menaxhmentit i vendos Bordi drejtues, duke pasur parasysh krahasimet me nivelin udhëheqës të sektorit financiar, të bankave dhe nivelin e përgjegjësisë dhe profesionalizmit që kërkohet. Në të ardhmen do të bëhet një analizë financiare e jashtme lidhur me çështjen e pagave të menaxhmentit dhe do ti dërgohet Parlamentit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014.

Mbledhja përfundoi në ora 13:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani